



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupstina Opstine
Municipal Assambly

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Fton

Të gjitha OJQ-të që merren me organizimin e aktiviteteve Sportive, Rinore ,Qendrën Rinore pra të gjitha OJQ që veprojnë në Komunën e Istogut që të aplikojnë me projekt-propozime për : Organizimin e garave në skijim për nxënës të shollave fillore .

Organizatat që aplikojnë për këtë aktivitet në projektin e tyre duhet të jenë të përshkruara qartë objektivat, aktivitetet sa më të detalizuara , përfituesit dhe buxheti.

Projekti duhet të jetë sa më i specifikuar në përshkrim pra të ceken aktivitetet që do të zhvillohen për këtë aktivitet .

Shuma e mbështetjes financiare për organizimi e këtij aktiviteti mund të jetë maksimum deri në 2500 euro.

Në këtë aktivitet duhet të përfshihen : Akomodimi i nxënësve , ushqimi tri racione ,shfrytëzimi i skive dhe ski lifiti për dy dite.

Përparësi do të kenë ato Organizata që :

1. Kanë përvojë të dëshmuar në organizimin e aktiviteteve të tilla .
2. Që kanë bashkëpunim me një apo më shumë OJQ .
3. Përparësi do të kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qartë dhe buxhetin e specifikuar.
4. Organizata që ofron dëshmi diploma të instruktoreve – mësime dhënësve të edukimit fizik .
5. Përparësi do të kenë organizatat që janë nga Komuna e Istogut .

Projekt - propozimet do të vlerësohen nga komision .

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 25.11.2019.

Projektet që aplikojnë pas këtij termini nuk do të shqyrtohen. Projektet duhet të dorëzohen në Kuvendin Komunal – Zyra nr 100.

Ne Kopje fizike të bashkangjitur me projekt propozim duhet të jete edhe certifikata – dëshmia e OJQ -se ,numri fiskal, kopja e letërnjoftimit,koja e kartelës bankare .

Nëse keni nevojë për informata shtese na kontaktoni ne :

Tel 049 766 009

049 766 585